

V E N D I M
Nr.247, datë 27.5.1993

**PËR SUBVENCIONIMIN NGA SHTETI TË NJË PJESE TË FATURËS SË SHPENZIMEVE
PËR PREPARATET MJEKËSORE TË NEVOJSHME PËR MJEKIMIN E INVALIDËVE**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Invalidët e grupit I dhe II për sëmundjet për të cilat janë deklaruar invalidë ose për të cilën marrin ndihmë ekonomike, të marrin barnat pa pagesë.
2. Invalidët e grupit III dhe IV për sëmundjet për të cilat janë deklaruar invalidë të marrin barnat kundrejt gjysmës së vleftës së recetës.
3. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit të nxjerrë udhëzimin përkatës për sëmundjet që konsiderohen kronike si dhe për mënyrën e organizimit të lëshimit të recetave për këtë kategori që do të përfitojë nga ky vendim.
4. Shuma prej 35.000.000 lekë për mbulimin e shpenzimeve për subvencionimin e barnave që do t'u jepen pa pagesë invalidëve sipas këtij vendimi për 9-mujorin e vitit 1993 të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 1993.
5. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për kryerjen e një studimi për shtrirjen e këtij sistemi edhe për kategoritë e tjera të pensionistëve me sëmundje kronike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi